

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Operatori Ekonomik” Sallillari.”

Adresa: Tiranë Vorë lagja “Vore “ Rruga e vjeter Vore Marikaj,Km 1 Godina katër katëshe.kati i trete ,Nr.5

Lloji i procedurës se prokurimit: “Procedure e Hapur-Punë.”

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Spostim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime në funksion të objektit: ”Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-70798-09-04-2020

Fondi limit: 238, 693,200,10(dyqind e tridhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind presje dhjetë)lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 6 muaj duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimeve.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 08/10/2020 Ora: 09:00

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bami J94416206R

Vlera 238,664,482.70(dyqind e tridhjetë e tetë million e gjashtëqind e gjashtedhjetë e kater mije e katerqind e tetdhjetë e dy presje shtatedhjetë)leke pa tvsh.

2. Ed Konstruksion shpk K61625001I

Vlera 238,639,830,68(dyqind e tridhjetë e tete million e gjashtëqind e tridhjetë e nenten mije e teteqind e tridhjetë presje gjashtedhjetë e tete)

3.Sallillari shpk J62903125G

Vlera 227,953,868,(dyqind e njezet e shtatë milion e nenteqind e pesedhjetë e tre mije e tetqind e gjashtedhjetë e tetë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë:

1. Bami

J94416206R

Vlera 238,664,482.70(dyqind e tridhjetë e tetë million e gjashtëqind e gjashtedhjetë e kater mijë e katerqind e tetdhjetë e dy presje shtatedhjetë)leke pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

gj.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës Bami sh.p.k Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori I sipercituar nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të vërtetuar *shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike cka bien në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.*

Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Në shtojcën 12 të DST shprehimisht parashikohet seRastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik Bami sh.p.k lidhur me pikën 2)gj është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në DST.

2.Ed Konstruksion shpk

K61625001I

Vlera 238,639,830,68(dyqind e tridhjetë e tete million e gjashtëqind e tridhjetë e nenten mije e teteqind e tridhjetë presje gjashtedhjetë e tete)

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së PARI: Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar si më poshtë cituar:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 8/1;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

g. Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	7 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc 35-45 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	5 cope	Pronësi ose me qera
Autobot për pastrim kanali dhe Puseta(vëllimi i botit mbi 20,000 l)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me vinc me peshë ngritje deri në 1,5 ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë stacionare betoni me kapacitet mbi 50 m3 në orë dhe presion mbi 55 bar	1 cope	Pronësi ose me qera
Rula vibrues	2 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera

Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi	2 copë	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 300 copë
 - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 20 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë
- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme).
- c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, UKT sha.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik të depozituar nga operatori ekonomik, Ed Konstruksion sh.p.k konstaton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur shtojcën Nr.10 për disponimin e mjeteve kusht i kërkuar në DST për procedurën objekt prokurimi.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk mund të gjykojë lidhur me plotësimin e kapacitetit teknik nga ana e shoqërisë “ Ed Konstruksion ” sh.p.k pasi KVO verifikon mjetet që përmban deklarata mbi disponueshmërinë e makinerive të dorëzuar nga operatori ekonomik.

Theksojmë se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve (sipas listës së mjeteve të kërkuara nga AK) pasqyron të gjitha mjetet që operatori vendos të angazhojë për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë , për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion ” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, nuk është përmbushur.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit pika 2.15 si më poshtë cituar:

2.15.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur:

1. Licensë kodi III.2.B” Grumbullim dhe Transporti i Mbetjeve Urbane”.
2. Licensë kodi III.2.B” Për grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve Inerte dhe Dherave”.
3. Licensë kodi III.2.B” Për grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve nga Ujrat e Ndotura”.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike KVO vëren se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të provuar dhe dëshmuar se disponon Licensë kodi III.2.B”Grumbullim dhe Transporti i Mbetjeve Urbane”, III.2.B” Për grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve Inerte dhe Dherave” III.2.B “Për grumbullimin dhe Transportin e Mbetjeve nga Ujrat e Ndotura” çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kërkuara në DST.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, ” Sallillari” sh.p.k është identifikuar si oferta e suksesshme. Vlera 227,953,868,(dyqind e njetzet e shtatë milion e nenteqind e pesedhjetë e tre mije e tetqind e gjashtedhjetë e tetë)lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **12.10.2020**

Ankesa: JO